



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Drejtoria e Financave, Sektori i tatimit në pronë bën këtë

NJOFTIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 26 janar 2018, ka miratuar Ligjin e ri për tatim në pronën e paluajtshme (*Ligji nr. 06/L-005*). Ligji është publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, më 15 shkurt 2018, dhe ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018.

Në bazë të këtij ligji vendoset tatimi në pronën e paluajtshme dhe përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga komunat dhe Ministria e Financave.

Mbi këtë bazë ligjore është vendosur, ndër të tjera, edhe

Tatimi mbi tokë, për njësitë e parcelave rezidenciale, komerciale, industriale, pyjore dhe bujqësore, (**tatimi mbi tokë**), ka filluar të zbatohet nga viti aktual tatimor 2019.

Nivelet e vlerave në €/m², janë të përcaktuara sipas zonës së vlerësimit për secilën kategori të pronës.

Vlera e tatueshme e një njësie parcele është si në vijim:

- për vitin e parë të vendosjes së tatimit, njëzetë për qind (20%) e vlerës së vlerësuar;
- për vitin e dytë të vendosjes së tatimit, dyzet për qind (40%) e vlerës së vlerësuar;
- për vitin e tretë të vendosjes së tatimit, gjashtëdhjetë për qind (60%) e vlerës së vlerësuar;
- për vitin katërt të vendosjes së tatimit, tetëdhjetë për qind (80%) e vlerës së vlerësuar dhe
- për vitet tatimore në vijim, njëqind për qind (100%) e vlerës së vlerësuar.

1. **Afatet e pagesave janë:** kësti i parë deri më **30 prill** dhe kësti i dytë deri më **30 shtator**. Pas datës së caktuar për pagesë, zbatohet interesi prej 0.65% për muaj dhe gjobë prej 10% mbi tatimin e papaguar.
2. **Afatet e ankesave ndaj faturës së tatimit në pronë:** Ankesa e tatimpaguesit dorëzohet së bashku me dokumentacionin mbështetës, me të cilin dëshiron të provojë pretendimet e tij, jo më vonë se dy (2) muaj nga dita e fundit për lëshimin e faturave të tatimit në pronë në atë vit tatimor.
3. **Shkarkimi i faturës së tatimit dha pagesat on line;** vizitoni faqen <https://fatura.tatimineprone-rks.org/> , **Si të paguaj online?**

Për çdo informatë më të hollësishme kontaktoni Sektorin e tatimit në pronë, Komuna Prishtinë, rr. "UÇK", nr. 55 ose përmes postës elektronike ZTP.Prishtina@rks-gov.net